

Mosdokumentimi i mallrave në transport

Subjektet gjatë ushtrimit të aktivitetit/aktiviteteve ekonomike të tyre, duhet që në transportin e mallrave, të përdorin dokumentet tatimore në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në rast të kundërt, tatimpaguesit rrezikojnë penalitetet sipas rasteve të mëposhtëme:

- Tatimpaguesit e Tatimit të Thjeshtuar të Fitimit, që nuk është i regjistruar në TVSH, menjëherë, në momentin e konstatimit i ndryshohet përgjegjësia tatimore, duke kaluar si tatimpagues i TVSH-së.
- Tatimpaguesi i regjistruar në TVSH detyrohet të dokumentojë mallin, duke lëshuar faturë tatimor. Po ashtu i kryhet rivlerësim i shitjeve në të njëjtën vlerë me vlerën e tregut të mallit të padokumentuar.

Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponëve fiskalë dhe të biletave

Tatimpaguesit janë të detyruar që, përveç rasteve kur ligji përjashtohen nga ligji, të përdorin pajisjet fiskale për lëshimin e kuponëve fiskalë dhe të biletave. Kundërvajtjet administrative lidhur me përdorimin e pajisjeve fiskale dënohen bazuar në dispozitat në fuqi të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit. Herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemeve të monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Nëse konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë ose sistemin e monitorimit të qarkullimit, merret masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 15 ditë kalendarike.

Nëse tatimpaguesi lëshon një kupon tatimor/dëftesë tatimore /biletë, me vlerë të parashtypur, që nuk përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore ose ku ka shënuar një vlerë të ndryshme nga vlera e furnizimit ose e çmimit të afishuar, për kuponin tatimor/dëftesën tatimore/biletën me vlerë të parashtypur, me gjobë, në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Tatimpaguesi ka detyrimin që të afishojë në një vend të dukshëm një njoftim që tregon detyrimin e blerësit të mallrave apo të përfituesit të shërbimit për të kërkuar kupon tatimor, si dhe të drejtën e blerësit për të mos paguar për mallrat dhe shërbimet e blera në zbatim të pikës 3, të nenit 46, të këtij ligji.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, tatimpaguesi duhet të mirëmbajë në kushte pune pajisjet fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit dhe në raste të defekteve të ndodhura në pajisjen fiskale ose sistemin e monitorimit të qarkullimit, njofton organet tatimore dhe ka detyrimin të plotësojë në rregull librezën fiskale të defekteve.

Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë të parashtypur, të prodhuara nga institucionet e autorizuar, të përdorura në sektorë të ndryshëm, dënohet me gjobë, në masën 10,000 (dhjetë mijë) lekë për çdo biletë.

Në rast se një tatimpaguesi i është bllokuar veprimtaria nga Administrata Tatimore dhe ai prish shenjat dalluese të vendosura për bllokim të veprimtarisë, atij i konfiskohet e gjithë sasia e mallit. Për këtë qëllim, grupi i kontrolli pasi bën inventarizimin e mallrave dhe evidentimin e tyre në procesverbalin përkatës, mban gjithashtu aktin për konfiskimin e mallrave.